

THE PHONOLOGICAL ELEMENT IN TEACHING THE FOREIGN LANGUAGE

Lindita Kazazi

University in Shkoder, Department of Roman Languages, lindita.kazazi@unishk.edu.al

Abstract: Traditionally, foreign language studies are mainly related to grammar and vocabulary learning. As a consequence, the question about the difficulties encountered during the course of learning a foreign language, most of the students underline the grammar. In our perspective, in addition to grammar and vocabulary, it is equally important to appreciate the phonological aspect of the foreign language, which is often overlooked, even if not to interrupt the conversation.

Through our work, we will try to bring to the attention the methods / texts used for learning the Italian language in Shkodra, at different levels of language, from different age groups and contexts. The aim is to remind our attention, as teachers / professors, the importance of the phonological element for improving the pronunciation, the difference of rhythm, accents and intonation. In our judgment, different exercises that intervene in the spoken language with the writing help not only sharpen the ear in the perception of new sounds but also help improve the pronunciation. Independent management of the phonological aspects of the language being studied improves both self-evaluation and self-correction capability.

Keywords: phonology, teaching, texts/methods. Field of the paper: Humanities

ELEMENTI FONOLOGJIK NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË HUAJ

Lindita Kazazi

Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Romanistikës, lindita.kazazi@unishk.edu.al

Tradicionalisht studimi i gjuhës së huaj lidhet kryesisht me mësimin e gramatikës dhe fjalorit. Për pasojë, pyetjet rreth vështirësive që ndeshen gjatë rrugëtimit të mësimin të një gjuhe të huaj, pjesa më e madhe e studenteve nënvizon gramatikën. Në këndvështrimin tonë, përveç gramatikës dhe fjalorit, po aq rëndësishëm vlen të çmohet edhe aspekti fonologjik i gjuhës së huaj, i cili shpesh anashkalohet, qoftë edhe për të mos ndërprerë bashkëbisedimin.

Përmes punës sonë, do përpiqemi të sjellim në vëmendje metodat/tekstet e përdorura për mësimin e gjuhës italiane në Shkodër, në nivele të ndryshme gjuhësore, nga grupmosha dhe kontekste të ndryshme. Synimi është të risjellim në vëmendjen tonë, si mësues/pedagogë, rëndësinë e elementit fonologjik për përmirësimin e shqiptimit, dallimin e ritmit, theksave dhe intonacionit. Në gjykimin tonë ushtrime të ndryshme që ndërthurin gjuhën e folur me atë të shkruar ndihmojnë jo vetëm mësimin e veshit në perceptimin e tingujve të ri, por edhe ndihmojnë në përmirësimin e shqiptimit. Menaxhimi në mënyrë të pavarur i aspekteve fonologjike të gjuhës që studiohet përmirëson njëherazi edhe aftësinë e vetëvlerësimit dhe vetëkorrigjimit.

Fjalë kyçe: fonologji, mësimdhënie, tekste/metoda. Shkenca Humane

ELEMENTI FONOLOGJIK NË MËSIMDHËNIEN E GJUHËS SË HUAJ

- *Cilët janë gabimet më të zakonshme të lidhur me shqiptimet e tingujve, të studentëve të vendit tuaj që mësojnë gjuhën italiane?*
- *A mund të studiohet fonetika që në fillimet e studimit të gjuhës së huaj?*
- *Kur dhe si do të korrigjohet shqiptimi i studentëve tuaj?*

Pasi bëhen këto pyetje, secili prej nesh udhëton të rigjëjë përvojat e kaluara që janë pjesë e rrugëtimit tonë.

“Çdo italian, pohon Mezzadri, është i aftë të imitojë një anglez që flet gjuhën italiane, ashtu siç është mjaft e thjeshtë të imitosh një italian që flet gjuhën angleze.”²⁸

Gjatë mësimdhënies së gjuhës së huaj, të shumta janë ushtrimet që mund të zhvillohen në klasë me synim nxjerrjen në pah të elementeve fonologjike dhe prozodikë të gjuhës që po studiohet. Po të zgjedhim një grup studentësh/nxënësish, ndër më të mirët, që të mund të imitojnë një shtetas rus, francez, gjerman që flet gjuhën italiane, duke krijuar një gërshetim të synimit didaktik me atë argëtues, do të mund të nënvizojmë karakterin më të shumti gojor të gjuhës.

Ushtrimi i propozuar, mund të përdoret në një orë mësimore, më pikësnyim të dyfishtë:

²⁸ Marco Mezzadri, I nuovi ferri del mestiere, Bonacci editore, Torino, 2015, f. 263.

së pari, fton nxënësit/studentët të reflektojnë mbi gabimet që lidhen me realizimet fonologjike të të huajve si dhe sjell vëmendjen në ndryshimet që ekzistojnë mes gjuhëve të ndryshme, sa i përket shqiptimit të tingujve apo grup tingujve që i japin jetë fjalëve dhe fjalive.

Së dyti, fton dhe drejton lexuesin të arsyetojë, rreth tipologjisë së gabimeve si psh. të lidhur me shqiptimin, realizimin e tingujve apo pasaktesiprozodike, intonative dhe ritmike të fjalive, të cilat ai nuk i ka konsideruar. Një ushtrim i tillë ndihmon në ndërgjegjësimin rreth një situatë deri diku të njohur, por që është e rëndësishme të vihet në dukje, në fillimin e studimit të një gjuhe të huaj.

Gjatë punës hulumtuese, ne kemi përpiluar një listë tekstesh të mësimdhënies së gjuhës italiane të përdorur në shkollat fillore, në arsimin mesëm (cikli i ulët dhe i lartë), universitete dhe në kontekste të tjera jashtë sistemit arsimor në nivele të ndryshme gjuhësore, me synim vëzhgimin e mesimdhënies së elementit fonetik (Si realizohet dhe sa është hapësira që i krijohet).

L Maddii – Maria Carla Borgogni, Forte 1-2/ Grandi amici, Edilingua, Roma. (scuola elementare).

Ky është një tekst që përshkohet nga elementë të vazhdueshëm të përditshmërisë dhe të realitetit të jetuar nga adoleshentët. Artistët, atletët, librat, muzika, zakonet dhe kalimi i kohës së lirë përshkruajnë të gjithanjësitë didaktike duke nxitur afrimin e nxënësve me gjuhën dhe kulturën italiane. Teksti i kushton vëmendje veçantë mesimdhënies për grupmoshën e adoleshentëve, me synim motivimin përmes një game të gjerë teknikash dhe ushtrimesh të bazuara më së shumti në lojë, të thjeshta për t'u kuptuar dhe argëtuese për t'u kryer.

Në të gjitha mësimet shfaqen të njëjtët personazhe, që jetojnë të njëjtat përvoja dhe përjetojnë të njëjtat probleme me adoleshentët, kanë të njëjtët interesa dhe përdorin të njëjtin kod komunikimi. Teksti merr formë të plotë edhe nga elementet gramatikore e trajtuara dhe ushtrimet që pasqyrojnë tipologjitë e ushtrimeve të certifikatave të gjuhës italiane si Plida apo Celi.

Nëse hedhim vështrimin në trajtimin e elementeve fonologjike, që na intereson më së shumti, shohim që vetëm në disa mësimet, fonologjia përfaqëson një pjesë më vete. Kjo ndodh kryesisht në mësimet e para, në të cilët paraqiten tingujt, disa elemente të përgjithshme rreth fonologjisë, pershkrim (përmes figurave) i sistemit të folurit/shqiptimit dhe vendosjes së organeve që mundësojnë emetimin e tingujve. Argument i rëndësishëm është edhe ai i bashkëtingëlloreve dyshe (le doppie). Gjithçka është e lidhur edhe me ortografinë: (c+a, o, u; c+h+i, e; c+i, e...). Me pak fjalë, elementi fonologjik trajtohet në fillim të tekstit, ndërsa në vazhdim ai është i ndërthurur me ushtrimet e dëgjimit, me situatat komunikuese dhe dialogjet.

Marin – Albano, Nuovo progetto italiano, Edilingua, Roma (tekst i përdorur në shkollat e mesme dhe klasat e 9-ta të seksioneve dygjuhëshe)

Teksti, kryesisht, përqendrohet në aspektin komunikues të gjuhës së huaj dhe në kompetencat gramatikore. Mësimet kanë pjesën hyrëse, e cila ka synim motivimin e nxënësit. Ndiqet nga tekste për t'u lexuar dhe/apo dëgjuar, analizë e teknikave të komunikimit, punë me tekstet dhe analizë e elementeve gramatikore, të cilat janë në funksion të komunikimit. Mësuesi luan rolin e animatorit, d.m.th. duhet të nxisë dialogun, duke mos pasur gjithmonë nën shënjestër korrektesinë gramatikore, e cila do të rimerret në një moment të dytë jashtë komunikimit. Mësimet përfundojnë me pjesën e rezervuar për elementin e qytetërimit, i cili ka synim pasurimin e fjalorit.

Nuk ndeshim një hapësirë të kushtuar për elementin fonologjik. Ky, si në metoda të tjera për mësimin e gjuhës, është i ndërthurur në ushtrimet e dëgjimit apo video të ndryshme, të cilat janë të regjistruara nga aktorë profesionistë apo intervista të shkëputura nga kontekste autentike, rreth tematikave që trajtohen në mësimet dhe ushtrimet e të folurit.

Toffolo- Nuti-Merklinghaus, Allegro 1/2, Edilingua, Roma, 2003

Tekstet synojnë të sjellin një panoramë rreth gjuhës, kulturës dhe qytetërimit italian përmes 12 njësive didaktike që përmban. Vetë teksti ka të organizuara hapësira përsëritjeje, që synojnë përmes lojës të rimarrin elementet gramatikore dhe leksikore të dhëna në mësimet e mëparshme. Nuk lihen asnjëherë pas dore elementet kulturore, meqësillen shpesh informacione rreth qytetërimit italian, jetës së përditshme, njerezve dhe vendeve, me pak fjalë, synohet të krijohet një dritare kundrimi e Italisë. Çdo mësim ka hapësirë të ushtrimeve që lejon reflektimin rreth njohurive të reja.

Sa i përket elementit fonologjik, vetëm në disa njësi didaktike ndeshim rubrikën 'fonetikë'. Në to kryesisht kemi shpjegime rreth shqiptimit të togjeve të bashkëtingëlloreve /gn/, /gl/, /sc/, /sch/ apo bashkëtingëlloret dyshe, tinguj/shkronjat e alfabetit. Pjesa e përmirësimit të shqiptimit, intonacionit, theksave dhe ritmit nënkuptohen në ushtrimet e dëgjimit, leximit, bashkebisedimit dhe hapësirës rezervuar për lojra.

TEKSTE TË PËRDORUR NË KURSET E GJUHES ITALIANE PËR MARRJEN E CERTIFIKATAVE TË GJUHES Plida/Celi

Giuseppe Patota/Norma Romanelli, Percorso Italia A1-A2; B1-B2, De Agostini scuola, Novara, 2008

Teksti paraqet një kurs multimedial të gjuhës italiane për të huaj, të ndarë në module të formuar nga 3 njësi didaktike secili. Në to përfshihen momente reflektimi gramatikor (të mbështetura nga ushtrime), fonetik dhe ortografik pa lënë mënjanë repertorin e gjerë të situatave nga jeta e përditshme.

Në çdo mësim, përveç funksioneve komunikative dhe përmbajtjeve gramatikore, ndeshemi me pjesën e fonologjisë, shpesh e ndërthurur me ortografinë dhe shenjat e pikësimit. Hapësira e fonologjisë, hapet me paraqitjen e alfabetit të gjuhës italiane (shqiptimin dhe leximin e tinguj-shkronjave), paraqitjen e veçantive të tingujve duke i krahasuar mes njëri-tjetrit duke nxjerrë në pah tiparet dalluese, gjatësinë e tingujve, theksat dhe intonacionet.

Marco Mezzadri/Paolo Balboni, Rete 1, Guerra edizioni, Perugia, 2009.

Marco Mezzadri/Paolo Balboni, Rete 2, Guerra edizioni, Perugia, 2009.

Tekstet janë të strukturuar në mësim, dhe secili prej tyre përshkohet nga një temë përfaqësuese e cila trajtohet dhe lejon shpjegimin e elementit gramatikor, leksikor, aftësive gjuhësore dhe fonologjike.

Elementi fonologjik, objekti ynë i studimit, shtjellohet në një sërë argumentesh. Analizohet - vlera e tingujve të gjuhës italiane, sipas vlerës dalluese në çifte bashkëtingëlloresh, - drejtshkrimi, duke i kushtuar shumë rëndësi rregullave të shkrimit të gjuhës italiane – bashkëtingëlloret dyshe, diftongjet dhe tritongjet, intonacioni (tonitë e ndryshme të gjuhës italiane). Përveç këtyre në tekste ndeshemi edhe me shembuj që përfaqësojnë të folura dialektore të Italisë. Këto i ofrohen studentëve në nivele të mira gjuhësore, B2 dhe i ndihmojnë ata të thyejnë veshin më forma të ndryshme të italishtes së folur në zona të ndryshme të Italisë (gjuha italiane në veri, jug, në Toskanë dhe Romë), duke servirur edhe informacione rreth dialektologjisë.

Nga kjo panoramë e përgjithshme e teksteve të përdorur për mësimdhënien e gjuhës italiane ne shkollet e qytetit të Shkodrës, rezultojnë se hapësira që i kushtohet elementit fonologjik pothuaj mungon. Nëse, nga njëra anë duket e pazakontmësimi sistematik i shqiptimit në klasë dhe të konsideruarit e tij në nivelin e duhur të rëndësisë, është edhe më e rrallë të gjenden materiale didaktike që lejojnë, sipas një hapësire dhe momenti të duhur trajtimin e elementeve prozodike (theksi, intonacioni apo ritmi i fjalive), gjatë praktikës së mësimdhënies. Në të vërtetë është **pranuar**, por akoma **nuk është lejuar**²⁹, që elementi fonologjik të jetë pjesë e vëmendjes së mësimdhënësit duke përbërë një hapësirë të veçantë në të cilën të ndërhyhet.

Pothuaj gjithmonë gjuha e huaj që po studiohet përmban tinguj të ndryshëm apo që nuk ekzistojnë në gjuhën mëmë të studentit. Kjo nënkupton nevojën e të ushtruarit të organeve të shqiptimit për të arritur kontrollin e emetimeve fonike me qëllim imitimin e tingujve dhe aspekteve prozodike të gjuhës së huaj për të mos shkaktuar ndërrime³⁰. Fonetika, në të vërtetë mund të studiohet që në hapat e para të mësimin të një gjuhe të huaj, sepse në këtë mënyrë nënvizohet karakteri më së shumti gojor i gjuhës, por edhe sepse përmes praktikimit vetë nxënësi/studenti vëren përmirësimet e arritura si në perceptim ashtu edhe në shqiptim.

Të shumta mund të jenë ushtrimet e sugjeruara në nivele të ndryshme të të nxënësve: përsëritje individuale ose në grup këngësh për të rritur e fëmijë, mësimi përmendësh dhe përsëritja e frazave të shkurta, dallimi i elementeve jashtëgjuhësorë në një pjesë dëgjimi, imitimi i intonacionit në fraza të ndryshme.

Të gjithë ne, në momente të caktuara i tejkalojmë vetëm gabimet fonologjike, por edhe ata gramatikore apo leksikore, për të mos ndërprerë ligjërimin, por është e rëndësishme që të ndërgjegjesojmë nxënësit/studentët për ekzistencën e tingujve të rinj. Synimi nuk është asnjëherë arritja e shqiptimit si folës të lindur të asaj gjuhe, porse të vendosurit e themeleve për përmirësime të metejshme, përmes praktikës. Në këtë këndvështrim mund të rezultojë motivues për nxënësit/studentët që hap pas hapi të zbulojnë folmet e shumta dhe të ndryshme të zonave të Italisë. Kjo do t'ia ushtrojë veshin në perceptimin e tingujve dhe do të ndihmojë në përmirësimin e shqiptimit. Ai që ushtrohet në dallimin dhe njohjen e theksave mëson të menaxhojë më mirë dhe në mënyrë të pavarur aspektet fonologjike të gjuhës që po studiohet e njëherazi përmirëson aftësinë vetëvlerësuese dhe vetëkorrigjuese. Në këtë pikëpamje studimi i fonetikës lidhet dhe ndërvepron me objektivat e zhvillimit të strategjive të të nxënësve.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Marco Mezzadri, I nuovi ferri del mestiere, Bonacci editore, Torino, 2015.
- [2] Alberto A. Sobrero, Introduzione all'italiano contemporaneo, Editori Laterza, Roma-Bari, 2004, f. 394.
- [3] Giorgio Graffi-Sergio Scalise, Le lingue e l'linguaggio, Il Mulino, Bologna, 2003.
- [4] L. Maddai – Maria Carla Borgogni, Forte 1-2/ Grandi amici, Edilingua, Roma.
- [5] Marin – Albano, Nuovo progetto italiano, Edilingua, Roma.
- [6] Toffolo- Nuti-Merklinghaus, Allegro 1/2, Edilingua, Roma, 2003

²⁹ Marco Mezzadri, I nuovi ferri del mestiere, Bonaccieditore, Torino, 2015, f. 262.

³⁰ Alberto A. Sobrero, Introduzione all'italiano contemporaneo, Editori Laterza, Roma-Bari, 2004, f. 394.

- [7] Giuseppe Patota/Norma Romanelli, Percorso Italia, De Agostini scuola, Novara, 2008.
- [8] Marco Mezzadri/Paolo Balboni, Rete 1, Guerra edizioni, Perugia, 2009.
- [9] Marco Mezzadri/Paolo Balboni, Rete 2, Guerra edizioni, Perugia, 2009.